




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit (MB) është mbështetja financiare për projektin: **“Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulture në Han të Elezit, faza e dytë”** që do të implementohet gjatë vitit 2021 dhe 2022.

1. AUTORITETET

Qëllim i Memorandumi do të përmbushet nga:

2.1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe

2.2. Komuna e Hanit të Elezit.

(në tekstin e mëtejshëm: Palët)

2. OBLIGIMET E PALËVE

3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (më tutje MKRS)

MKRS-ja merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

3.1.1. Të sigurojë shumën prej 480,000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) euro për implementimin e projektit “Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulture në Han të Elezit, faza e dytë”;

3.1.2. Të emërojë një organ mbikqyrës për mbikqyrjen e punimeve;

3.1.3. Palët pajtohen që në rast se paraqitet nevoja për mjete shtesë për realizimin e këtij projekti do të negociohet marrëveshje e re bashkëpunimi.

3.1.4. Në bashkëpunim me Komunën e Han të Elezit, kujdesen për implementimin e projektit.

3.2. OBLIGIMET E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

Komuna e Hanit të Elezit merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

3.2.1. Të bëjë hartimin e projektit “Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulture në Han të Elezit, faza e dytë”;

3.2.2. Të udhëheq procedurat e prokurimit për projektin “Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulture në Han të Elezit, faza e dytë”;

3.2.3. Të sigurojë lejet e nevojshme ndërtimore;

3.2.4. Në bashkëpunim me MKRS-në kujdesen për implementimin e projektit në fjalë.

4. ZBATIMI

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Komunën e Hanit të Elezit përcjellin zbatimin e Memorandumi të Bashkëpunimit dhe udhëzojnë për veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e obligimeve në mbarëvajtjen e punimeve, deri në momentin e realizimit të qëllimit.

5. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PAPARESHIKUARA

- 5.1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet me marrëveshje ndërmjet palëve.
- 5.2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të fuqisë mbinatyrore – Vis major dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

6. AFATI I REALIZIMIT

Afati i realizimi të qëllimit të Memorandumit të Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2021 dhe 2022.

7. AMANDAMENTIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MB, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MB në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MB-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRËVESHJEVE

Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë.

9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

Ibër ALAJ

Zv. Sekretar i Përgjithshëm
i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Rufki SUMA

Kryetar i Komunes së Hanit të Elezit

Nënshkruar më 13 / 10 / 2021
Prishtinë